Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "NNSH Vizion Project" të datës 28.09.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "184 – Studimi i fizibilitetit për furnizim me ujë përmes puseve dhe rezervuarëve në fshatrat e Gollakut" me nr. të prokurimit 616-26-5518-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "NNSH Vizion Project" të datës 28.09.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "184 – Studimi i fizibilitetit për furnizim me ujë përmes puseve dhe rezervuarëve në fshatrat e Gollakut" me nr. të prokurimit 616-26-5518-5-2-1.

II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.

III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën https://e-prokurimi.rks-gov.net.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "NNSH Vision Project" (tutje "parashtruesi") me datë 28.09.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "184 – Studimi i fizibilitetit për furnizim me ujë përmes puseve dhe rezervuarëve në fshatrat e Gollakut" me nr. të prokurimit 616-26-5518-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Pretendimet ankimore të parashtruesit:
"*Letra e eliminimit në B58, datë 21.09.2026, e mbështet refuzimin tonë vetëm në mungesën e Licencës A për Inxhinierin e Gjeodezisë. Ajo nuk identifikon mangësi tjetër të ofertës sonë. AK-ja e ka mbajtur këtë përfundim edhe pas përgjigjes sonë të datës 31.08.2026, me të cilën kemi identifikuar licencën e AKK-së në ofertën fillestare dhe kemi sqaruar bazën e saj ligjore.*
Me posht po i listojm gjetjet tona sa i përket OE të rekomanduar për kontratë:
7.2 Emërimi i menaxherit paraqitet në emër të një grupi tjetër
7.3 Autorizimi profesional i Almedina Rapucës".

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eleminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

ARSYETIM
Ju njoftojmë se oferta juaj është refuzuar, pasi është vlerësuar si e papërgjegjshme për arsyet në vijim:
Gjatë procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktues, përmes sistemit elektronik të prokurimit, më 26.08.2026, ka kërkuar nga GOE sqarime dhe dokumentacion shtesë lidhur me dëshmimin e përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë. Sqarimet dhe dokumentacioni shtesë janë dorëzuar nga GOE përmes sistemit të e-Prokurimit më 31.08.2026.
Pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofertës, si dhe të sqarimeve dhe dokumenteve shtesë të dorëzuara, Komisioni i Vlerësimit ka konstatuar se GOE nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e plotë të kërkesave të Autoritetit Kontraktues.
Bazuar në ekzaminimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të ofertës, si dhe të sqarimeve dhe dokumentacionit shtesë të dorëzuar nga GOE, Komisioni i Vlerësimit konstaton se Grupi i Operatorëve Ekonomikë nuk ka dëshmuar përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, përkatësisht sa i përket (*Inxhinierin e Gjeodezisë*), për të cilët mungon Licenca A.

Pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, është konfirmuar konstatimi i komisionit vlerësues mbi bazën e vlerësimit të ofertës dhe sqarimeve shtesë, që lidhur me kërkesën për inxhinierin e gjeodezisë mungon licensa A e kërkuar sipas DT. Përndryshe as me kërkesën për rishqyrtim parashtruesi nuk e ka prezantuar dokumentin sipas DT.

Po ashtu edhe sa i përket pretendimeve të parashtruesit kundër tenderuesit të rekomanduar, AK i ka faluar besimin të gjeturave të komisionit vlerësues sipas të cilave tenderuesi i rekomanduar i ka përmbushur të gjitha kërkesat e DT duke përfshirë edhe vendimin për menaxherin e kontratës dhe inxhinierën A.R.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eleminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 30.09.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net